

RENDI RAJONAL DHE GLOBAL

PROCESI I BERLINIT NË SFONDIN E RI TË SIGURISË NË EUROPE

Ditmir Bushati
Albana Merja
Glevin Dervishi

Tetor 2023

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
2.	ECURIA E PROCESIT TE BERLINIT	5
2.1	Dimensioni Politik	5
2.2	Dimensioni Ekonomik	6
2.3	Dimensioni Social	7
3.	PROCESI I BERLINIT DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL	8
4.	BALLKANI I HAPUR LEHTËSUES APO ALTERNATIVË NDAJ PROCESIT TË BERLINIT?	10
5.	SFIDAT QË KËRKOJNË PËRGJIGJE	14
6.	ZEITENWENDE DHE IMPLIKIMET E TIJ PËR BALLKANIN PERËNDIMOR	16
7.	BIBLIOGRAFIA	18

1

HYRJE

Në vitin 2014 panorama e përgjithshme e procesit të zgjerimit nuk ishte premtuese për Ballkanin Perëndimor. Zbehja e angazhimit të BE-së në rajon ishte përvijuar prej vitesh. Madje vetë BE-ja ishte më shumë e orientuar në trajtimin e krizave të saj të brendshme. Që prej Samitit të Selanikut të vitit 2003, vetëm Kroacia ka arritur të bëhet pjesë e BE-së, dhe që prej janarit 2023 pjesë e zonës Euro dhe Schengenit. Rrëzimi i projektit të Kushtetutës Europiane nga francezët dhe holandezët në vitin 2004, kriza financiare e vitit 2008 dhe kriza e refugjatëve në vitin 2015 mbizotëruan narrativën politike në një pjesë të mirë të vendeve anëtare të BE-së.

Në vitin 2014 Presidenti i Komisionit European, Juncker, deklaroi se nuk do të kishte një zgjerim të mëtejshëm të BE-së gjatë mandatit të tij pesëvjeçar.¹ Kjo deklaratë ishte treguesi më i qartë i faktit se procesi i zgjerimit e kishte humbur entuziazmin e dikurshëm dhe mbështetjen politike. Sikur të mos mjaftonin sfidat e brendshme, aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia po atë vit, tronditi arkitekturën e sigurisë në Europë.

Ndërkohë rruga e Ballkanit Perëndimor u shoqërua me sfidat e konsolidimit të demokracisë, të hendekut zhvillimor, të funksionimit të institucioneve dhe të polarizimit të tejskajshëm të jetës politike. Për më tepër, një mori mosmarrëveshjesh dypalëshe, që kanë të bëjnë me projektet e papërfunduara të shtetësisë, me çështjet identitare, me çështjet e kufijve, me pakicat dhe me procesin e pajtimit, mbartin një potencial të lartë për destabilitet rajonal. Këto mosmarrëveshje shfrytëzohen nga aktorë të huaj në funksion të agjendave përçarëse në rajon. Ndaj përqaftimi i një qasjeje aktive të BE-së në rajon çimenton rolin e saj si një aktor efektiv në tejkalimin e mosmarrëveshjeve dhe adresimin e tyre në një plan më të gjerë european. Por në të njëjtën kohë, do të garantonte një proces anëtarësimi të vendeve të rajonit në BE, të bazuar në merita dhe jo një proces të eklipsuar nga mosmarrëveshjet e mësipërme.

Ky punim analizon arritjet dhe sfidat me të cilat përballet Procesi i Berlinit, i cili u prezantua si një platformë gjithëpërfshirëse e bashkëpunimit rajonal me synim

përparimin e vendeve të rajonit drejt BE-së. Gjithashtu, punimi trajton rolin që ky proces ka luajtur në rritjen e bashkëpunimit rajonal, sikundër evidenton sfidat kryesore me të cilat përballet marrëdhënia ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Në kushtet e reja të sigurisë në kontinent si pasojë e agresionit të Ruisë mbi Ukrainën, punimi shoqërohet me rekomandime që synojnë konsolidimin e projektit european përmes një ndërlidhjeje më të mirë të Procesit të Berlinit dhe procesit të integritimit european për vendet e Ballkanit Perëndimor.

¹Për më shumë shih fjalimin e Jean-Claude Juncker: https://ec.europa.eu/commission/press-corner/detail/en/SPEECH_14_567

2

ECURIA E PROCESIT TË BERLINIT

Gjermania, si fuqia kryesore politike dhe ekonomike në BE, bazuar në situatën gjeopolitike të lartpërmendur, u angazhua për ta kyçur Ballkanin Perëndimor në një proces dinamik me vështirësi nga e ardhmja, nëpërmjet një platforme e cila më pas u shndërrua në “Procesin e Berlinit”.² Prosesi u konceptua që prej fillimit si një plotësues dhe jo zëvendësues i procesit të anëtarësimit në BE, duke u mbështetur në tri shtylla kryesore: (i) dimensionin politik, me synim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, në funksion të forcimit të marrëdhënive të fqinjësisë së mirë dhe stabilitetit rajonal; (ii) dimensionin ekonomik, me synim zhvillimin e projekteve të përbashkëta të infrastrukturës dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike në rajon; (iii) dimensionin social, me theks të marrëdhëniet e shoqërisë civile dhe ndërveprimi njerëzor.³

Me kalimin e viteve, Prosesi i Berlinit pësoi ndryshime që pasqyrojnë angazhimin strategjik gjerman dhe atë të BE-së në rajon, por edhe nevojën për të thelluar bashkëpunimin rajonal duke zgjeruar pjesëmarrësit, aktorët dhe dimensionin e bashkëpunimit.⁴ Pas pothuajse nëntë vitesh nga konceptimi i tij, Prosesi i Berlinit është shoqëruar me optimizëm dhe zhgënjim, arritje dhe sfida.⁵ Për një panoramë më të qartë të ecures së tij, është e rëndësishme që të analizohet secili dimension, si dhe impakti i këtij procesi në jetën e përditshme.

2.1 DIMENSIONI POLITIK

Si rezultat i formateve të ndryshme të angazhimit, Prosesi i Berlinit ka krijuar një sens barazie në përfaqësim, të drejta e detyrime, mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Kjo evidentohet në mbledhjet periodike të udhëheqësve të vendeve të rajonit, me simbolet përkatëse shtetërore, çka përbën një mesazh të rëndësishëm politik në vetvete. Prosesi i Berlinit synonte një ndërlidhje më të mirë dhe më organike mes integritit të rajonit në BE dhe bashkëpunimit rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Angazhimi i BE-së nëpërmjet instrumenteve financiare synon jetësimin e agjendës zhvillimore të rajonit. Në të njëjtën kohë, përçon mesazhin e qartë se Prosesi i Berlinit nuk është një çmim ngushëllues për mospërparimin në procesin e anëtarësimit në BE.

Nënshkrimi nga ministrat e Punëve të Jashtme i Deklaratës së Përbashkët për zgjidhje paqësore të çështjeve dypalëshe gjatë Samitit të Vjenës në vitin 2015, ishte hapi i parë në këtë drejtim, ndonëse rezultatet në praktikë janë të kufizuara. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për impaktin në praktikë të Deklaratës së Përbashkët për personat e zhdukur dhe krimet e luftës, të nënshkruar në Samitin e Londrës në vitin 2018, e cila përbën të parin dokument angazhues mes vendeve të rajonit për këtë çështje. Pavarësisht angazhimit të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Berlinit, ecuria në fushën e gjetjes së personave të zhdukur nuk është mbresëlënëse.⁶

Procesi i Berlinit është përpjekur të nxitë procesin e reformave në kuadër të qeverisjes së mirë. Gjatë vitit 2018 vendet e Ballkanit Perëndimor u angazhuan për një qasje më aktive në funksion të sundimit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, qeverisjes së mire, duke theksuar rëndësinë e vetëpërmbytjes nga retorika populiste dhe nacionaliste në Samitin e Brdo-Brijunit të mbajtur në 27 prill 2017.⁷

²Më posaçërisht, gjatë takimit të Procesit të Brdo-Brijunit në Dubrovnik në korrik të vitit 2014, Kancelarja Merkel shpalli Samitin e Berlinit i cili u mbajt në 28 gusht të po atij viti në Berlin. Sipas ambasadorit gjerman Hellmut Hoffmann që shërbeu në Shqipëri gjatë viteve 2013-2016, “Në kujtim të fillimit të Luftës së Parë Botërore, Gjermania ndërmori iniciativën e organizimit të një serie takimesh vjetore, me një shtrirje fillimisht katër vjeçare të disa prej shteteve më kyçe të BE-së me gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Pak kohë më pas, ministri i ri i punëve të Jashtme Ditmir Bushati, i angazhuar për një afrim të shpejtë me BE-në, futi në përdorim termin “Procesi i Berlinit”. Gjithsesi, duke qenë se në Ballkan asokohe organizoheshin shumë forume, të cilat mbeteshin në kuadrin e takimeve rutinë dhe deklaratave diplomatike, unë kisha bindjen se Konferenca e Ballkanit Perëndimor do të përfaqëonte një vlerë shtesë, nëse do të ndërmerre projekte konkrete”. Për më shumë shih: Hellmut Hoffmann, Enrico Seewald, “Vazhdimësi dhe Shkëputje: Shqipëria dhe shtetet gjermane 1912-2021”, Shtëpia Botuese Onufri, 2022

³Për më shumë shih: “The Achievements and the Future of the Berlin Process”, <https://www.berlinprocess.de/en/the-achievements-and-the-future-of-the-berlin-process-40>.

⁴Sot procesi ka në përbërje të tij gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, nëntë anëtarë të BE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, bizneset, institucionet e BE-së (KE, Shërbimi i Jashtëm, vendin anëtar që mban presidencën e Këshillit të BE-së), Institucionet financiare ndërkombëtare, Iniciativat Rajonale (RCC, SEETO, Enc, CEFTA, RYCO, RAI).

⁵Për më shumë shih: “The Berlin Process in a Nutshell”, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2018: https://www.giz.de/en/downloads_els/The_Berlin_Process.pdf

⁶Mbi 1.600 persona konsiderohen ende të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. Në Deklaratë, ndër të tjera, thuhet se i jepet qasje e plotë në të gjitha materialet, shënimet, urdhrat, dokumentet, videot, regjistrimet audio dhe të gjitha dokumentet e tjera, përfshirë ato që kanë statusin “konfidenciale” dhe që janë në posedim të institucioneve të Kosovës dhe Serbisë. Ndaj, për të pasur rezultate në këtë çështje shumë të ndjeshme, në vazhden e dialogut Kosovë-Serbi, në 2 maj 2023 u nënshkrua Deklarata për Personat e Zhdukur, si pjesë e Dialogut të Nivelit të Lartë Politik, që sjell shpresë të re, sepse palët janë zotuar të lejojnë aksesin në të gjitha dokumentet në posedim të tyre, përfshirë ato të shënuara si ‘konfidenciale’. Prosesi i Brdo-Brijunit, i iniciuar nga Sllovenia dhe Kroacia, si dy vende anëtare të BE-së, me pjesëmarrjen e vendeve kandidate dhe kandidate potenciale të Ballkanit Perëndimor, që ka në fokus integrimin në BE, forcimin e dialogut politik, rritjen e besimit, zgjidhjen e çështjeve dypalëshe.

Po në kuadër të dimensionit politik, u nënshkrua Deklarata e Përbashkët Kundër Korrupsionit (2017) dhe Deklarata për Integrimin e Romëve (2018). Angazhimet e mësipërme janë përkthyer në dokumente strategjike dhe plane veprimi nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në funksion të krijimit të një fryme të re bashkëpunimi ndërmjet administratave dhe rritjes së kapaciteteve drejtuese, u ra dakord për zbatimin e projektit pilot për nëpunësit e rinj civilë, duke ofruar dhe mundësi lëvizshmërie, megjithëse deri më tani nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme në këtë drejtim.

Në fushën e mirëqeverisjes, duhet pranuar se Procesi i Berlinit nuk ka qenë në gjendje të ofrojë instrumente që përmirësojnë sistemin e qeverisjes në përputhje me standardet europiane.

Përgjatë këtyre viteve, sipas matjeve të institucioneve ndërkombëtare, vendet e rajonit, me përjashtim të Kosovës, kanë pësuar "rreshqitje demokratike".⁸

Gjatë pandemisë u evidentua një bashkëpunim i shtuar mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në dhënien e ndihmës së ndërsjellë jashtë kuadrit të Procesit të Berlinit. Në fazën e parë vendet e BE-së, anëtare të Procesit të Berlinit, u treguan ngurruese për dhënien e medikamenteve dhe të pajisjeve mjekësore. Mungesën e veprimit të BE-së e shfrytëzuan aktorë të tjerë si Kina, Rusia, Turqia, si një mundësi për ushtrimin e ndikimit të tyre në rajon. Kështu, vendet e Ballkanit Perëndimor u kthyen në një zonë konkurrence për përdorimin e medikamenteve dhe të pajisjeve mjekësore për përbalimin e pandemisë.

Gjatë fazës së dytë të pandemisë bashkëpunimi rajonal shënoi një ecuri pozitive në lidhje me lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe medikamenteve, ku vendet e Ballkanit Perëndimor vendosën t'i bashkohen nismës së BE-së për zbatimin e "Green Lanes", ku çdo kontroll shëndetësor dhe i mallrave nuk duhet të kalonte më shumë se 15 minuta.⁹

2.2 DIMENSIONI EKONOMIK

Procesi i Berlinit nuk ka një zë buxhetor të veçantë. Projektet e miratuara për secilin shtet financohen pjesërisht nga instrumentet e BE-së dhe pjesërisht nga vetë shtetet. Për t'i dhënë jetë hartimit dhe realizimit të projekteve prioritare rajonale në kuadër të Procesit të Berlinit, vendet e Ballkanit Perëndimor krijuan Komitetet Kombëtare të Investimeve, të

cilët janë gjithashtu përgjegjëse për programimin e burimeve të financimit nga partnerët e huaj. Komisioni Europian, nëpërmjet Kornizës së Ballkanit Perëndimor për Investime, bashkëfinancoon projekte të energjisë dhe të transportit nga lista e projekteve me interes të Komunitetit të Energjisë dhe të Rrjetit Trans-Europian të Transportit.¹¹ Një rol të rëndësishëm në financimin e këtyre projekteve luajnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare të kreditimit, si Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Europiane për Investime dhe Banka Botërore.

Shtetet pjesëmarrëse të Procesit të Berlinit i kanë dhënë përparësi agjendës së ndërlidhshmërisë, e cila synon përmirësimin e ndërlidhjes infrastrukturore mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, si një mundësi për përfitime të dyanshme ekonomike. Në kuadër të ndërlidhshmërisë, Procesi i Berlinit ka vepruar nëpërmjet masave të forta, të cilat përfshijnë projektet infrastrukturore rajonale dhe kombëtare, dhe masave të buta, të cilat përfshijnë procedurat e qarkullimit ndërkufitar, reformat në fushën e sigurisë në sistemet e transportit, skemat e mirëmbajtjes së rrjeteve infrastrukturore, si dhe masa të tjera strategjike në funksion të lehtësimit të integritetit rajonal.

Fokusi tek ndërlidhshmëria vjen si rezultat i nevojave të rajonit tonë, i cili ka një mesatare më të ulët të shtrirjes dhe aksesit në rrjetet infrastrukturore, energjetike dhe të ndërlidhjes krahasuar me vendet anëtare të BE-së.¹² Në këtë kontekst, Procesi i Berlinit ndryshoi disi rutinën e formatit të zgjerimit duke e vendosur theksin te bashkëpunimi rajonal ekonomik ku krahas strukturës klasike vertikale të procesit të zgjerimit, shtoi elementë horizontale me çështje të tilla si: tregu i përbashkët rajonal, transporti, energjia dhe zona ekonomike rajonale, duke nxitur kështu kushtet për zhvillim të qëndrueshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet agjentëve të ndryshëm shoqërorë.¹³

Falë Procesit të Berlinit rajoni u vendos në hartën europiane të transportit dhe energjisë, duke orientuar instrumentet financiare të BE-së dhe buxhetet kombëtare të shteteve të Ballkanit Perëndimor në përputhje me këto prioritete. Po kështu, në Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit Europian të vitit 2018 u përvijuan gjashtë nisma: transporti, ndërlidhja energjetike, agjenda digjitale, zhvillimi ekonomik e shoqëror, sundimi i së drejtës e siguria, dhe migracioni, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërshtetëror.¹⁴

¹⁰Që nga viti 2009, WBIF ka mbështetur 44 projekte që kapin vlerën 3.2 miliardë euro të investuara në sektorin publik në Shqipëri. Vendi ynë ka përfituar prej dhënies së 62 granteve me vlerë 355.6 milionë euro në asistencë teknike dhe bashkëfinancim investimesh. Mbështetja nga instrumenti IPA i BE-së, e kanalizuar përmes WBIF, kap vlerën 337.6 milionë euro, që mbulon si asistencë teknike dhe investimin. Donatorë të tjerë kanë kontribuar brenda kësaj pakete në vlerën 18 milionë euro. Për më tepër shih: <https://www.wbif.eu/beneficiaries/albania>.

¹¹Korniza e Ballkanit Perëndimor për Investime ka bashkëfinancuar në formën e granteve të investimit dhe të asistencës teknike projekte në sektorët e energjisë, mjedisit, zhvillimit e sektorit privat, çështjeve sociale, transportit dhe infrastrukturës digjitale. Në total kjo kornizë ka ndarë 2.6 miliardë euro grante për përfituesit e saj nga Ballkani Perëndimor. Gjithashtu janë dhënë dhe 7.3 miliardë euro në kredi të nënshkruara për projekte që kapin vlerën totale prej 25.6 miliardë euro, shih: <https://www.wbif.eu/technical-assistance-grants#investments>.

¹²Për më shumë shih: "The Berlin Process in a Nutshell", Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH: https://www.giz.de/en/downloads_els/The_Berlin_Process.pdf

¹³Për më shumë shih: Ditmir Bushati, "Ripërtëritja e Procesit të Berlinit", 2022: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/19730.pdf>

¹⁴Po aty

⁸Për më shumë shih raportet e organizatave ndërkombëtare si: Freedom House Nations in Transit Report, Transparency International, World Justice Project, të cilat tregojnë rënie në indikatorët matës të nivelit të demokracisë apo funksionimit të shtetit të së drejtës dhe rritje të perceptimit të korrupsionit nga qytetarët në rajon. ⁹Për të vijuar lëvizjen e lirë dhe me efikasitet të mallrave në të gjithë BE-në, më 23 mars 2020 Komisioni Europian lëshoi këshilla praktike për zbatimin e "korsive të gjelbra", sipas të cilave, në pikat e kalimit kufitar të gjitha automjetet dhe mallrat duhet t'u nënshtroheshin kontrolleve, përfshi edhe atyre shëndetësore, jo më shumë se 15 minuta. Më 29 prill 2020, Komisioni propozoi një rregullore që përcaktonte masa specifike dhe të përkohshme në funksion të parandalimit të COVID-19. Kjo rregullore kishte të bënte me vlefshmërinë e disa certifikatave, licencave dhe autorizimeve. si dhe shtyrjen e disa kontrolleve periodike dhe trajnimeve në fusha të caktuara të legjislativitetit të transportit.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i bashkëpunimit rajonal është Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila është një strategji rajonale që fokusohet në ekonominë e qendrueshme në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Europiane. Ajo përaftron rajonin me ambicien e BE-së për ta bërë Europën neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050,¹⁵ sikundër shërben si mundësi për orientimin e rajonit drejt tranzicionit energjetik dhe investimeve në infrastrukturë. Në këtë kontekst, në Samitin e Berlinit të vitit 2022 u miratua Deklarata për Sigurinë e Energjisë dhe Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Gjermania u angazhua të investojë deri në gjysmë miliardë euro për tejkalimin e vështirësive energjetike në Ballkanin Perëndimor dhe deri në 1 miliard euro për mbështetjen e tranzicionit afatgjatë energjetik në rajon. Këto angazhime shkojnë paralelisht me “paketën e energjisë” prej 500 milionë eurosh që Komisioni i BE-së synon t’i japë rajonit si ndihmë emergjente.

Në kuadër të dimensionit ekonomik, projekti më ambicioz deri tani është krijimi i Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM), i miratuar gjatë Samitit të Sofjes të vitit 2020. Qëllimi i CRM-së është sigurimi i lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve (“katër liritë”), përfshirë aspektet që lidhen me investimet digjitale, inovacionin dhe politikën e industrisë. CRM konsiderohet si një hap përgatitor drejt integritetit të ardhshëm të rajonit në tregun e brendshëm të BE-së. Pajtueshmëria me “katër liritë” është një parakusht për pranimin në tregun e brendshëm të BE-së dhe pjesë e *acquis communautaire*.

CRM u themelua mbi shtratin e krijuar nga Zona Ekonomike Rajonale (REA), e cila u iniciua gjatë Samitit të Triestes të vitit 2017. REA parashihte zbatimin e “katër liritëve” të përqendruar në këto fusha: integrimi digjital; lëvizshmëria; tregtia; dhe investimet. Marrëveshjet e nënshkruara në Samitin e Berlinit në vitin 2022 për lirinë e lëvizjes dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave të arsimit të lartë dhe kualifikimeve profesionale në fushën e mjekësisë dhe arkitekturës bazohen gjithashtu mbi këtë nismë dhe tani janë pjesë e CRM.¹⁶

Nëse do të renditim disa nga arritjet në fushën e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik të Procesit të Berlinit gjatë këtyre viteve, vërejmë se janë hartuar dhe realizuar 37 projekte në fushën e transportit, 8 projekte në fushën e energjisë, 2 programe në fushën e energjisë së rinovueshme, investime në infrastrukturën e brezit të gjelbër (digjital), si dhe janë zbatuar masat e buta në energji dhe transport. Është ngritur Forumi i Investimeve i Komunitetit të Transportit Rajonal të Zonave Ekonomike të Dhomave të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Procesi ka dhënë mbështetje për

SME-të nga Fondi për Inovacionin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe ka nisur puna për funksionimin e Tregut të Përbashkët Rajonal. Gjithashtu, në Samitin e Tiranës ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, më 6 dhjetor 2022, operatorët telefonikë nënshkruan marrëveshjen për uljen e tarifave të roaming-ut, e cila do të nisë zbatimin nga data 1 tetor 2023. Ulja e kostove të roaming-ut ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së do të mundësojë kushte më të mira dhe nxitje për bizneset, por ajo konsiderohet dhe si një stimul për turizmin.

2.3 DIMENSIONI SOCIAL

Në kuadër të dimensionit social të bashkëpunimit dhe forcimit të lidhjeve njerëzore, shoqëria civile konsiderohet një aktor i rëndësishëm për nxitjen e përgjegjshmërisë politike dhe promovimin e reformave që lidhen me anëtarësimin në BE.¹⁷ Në këtë kuadër, një nga arritjet e Procesit të Berlinit është krijimi i Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO) me seli në Tiranë. RYCO u krijua sipas modelit franko-gjerman të pas Luftës së Dytë Botërore në Samitin e Parisit të vitit 2016.¹⁸ RYCO paraqet një potencial të madh për formësimin e brezit të ri në rajon, duke i bërë ata protagonistë të ndryshimit.¹⁹

Një instrument tjetër plotësues në fushën e bashkëpunimit rinor është edhe Fondi i Ballkanit Perëndimor, me seli po në Tiranë, i bazuar në modelin e vendeve të Vishegradit V4, që u ngrit pas nënshkrimit nga Ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në nëntor të vitit 2015.²⁰ Fondi synon rritjen e bashkëpunimit, forcimin e kohezionit social dhe përparimin e vendeve të rajonit drejt BE-së, duke angazhuar përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimor, komunitetit të sipërmarrjes dhe autoriteteve vendore.

Në kuadër të Procesit të Berlinit u krijuan gjithashtu Forumi i Shoqërisë Civile si një platformë që bashkon think-tank-et dhe organizatat e shoqërisë civile, Fourni Rinor dhe Forumi i Biznesit. Këto forume kontribuojnë në proceset politike të rëndësishme për rajonin duke vënë në dispozicion të vendimmarrësve ekspertizën më të fundit dhe gjetjet në terren.

Vlen të theksohet dhe organizimi i përvitshëm i Konferencës së Përbashkët të Shkencës, e cila bashkon akademikë e shkencëtarë nga rajoni dhe vendet e BE-së, të cilët diskutojnë sfidat aktuale dhe përmirësimet e mundshme për sistemet shkencore në Ballkanin Perëndimor.

¹⁵Kjo strategji u miratua në Samitin e Sofjes në 2020 dhe Plani i Veprimit të saj u miratua në Samitin e Brdo-s në tetor 2021. Objektivat e Agjendës së Gjelbër fokusohen në pastrimin e burimeve të energjisë, mbrojtjen e klimës, kalimin drejt një Kjo strategji u miratua në Samitin e Sofjes në 2020 dhe Plani i Veprimit të saj u miratua në Samitin e Brdo-s në tetor 2021. Objektivat e Agjendës së Gjelbër fokusohen në pastrimin e burimeve të energjisë, mbrojtjen e klimës, kalimin drejt një ekonomie rrethore, pastrimin nga ndotja të ajrit, ujit dhe tokës, ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit, si dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve.

¹⁶1. Marrëveshja mbi lëvizjen e lirë me karta identiteti në Ballkanin Perëndimor; 2. Marrëveshja mbi njohjen e diplomave të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor; 3. Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve, arkitektëve në kontekstin e marrëveshjes për tregtinë e lirë në Europën Qendrore.

¹⁷Shih: Velina Lilyanova, “The Western Balkans’ Berlin process: A new impulse for regional cooperation”, European Parliamentary Research Service, 2016: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI\(2016\)586602_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI(2016)586602_EN.pdf)

¹⁸RYCO fokusohet tek projektet rinore në pesë fusha prioritare: (i) nxitjen e bashkëpunimit rajonal; (ii) rritjen e lëvizshmërisë; (iii) përkrahjen e pajtimit; (iv) ndërtimin e paqes dhe stabilitetit; dhe (v) sigurimin e një të ardhmeje të begatë për të rinjtë në vendet e tyre përkatëse. Që prej themelimit të RYCO, rreth 25 mijë të rinj janë bërë pjesë e programeve të shkëmbimit rinor dhe mobilitetit.

¹⁹Shih: “Monitoring the Berlin Process: From Paris to Trieste”, Working Paper, Cooperation and Development Institute / ShtetiWeb, 2017: <https://www.connectwith.eu/wp-content/uploads/2019/07/Monitoring-the-Berlin-Process-From-Paris-to-Trieste.pdf>

²⁰Që prej themelimit Fondi i Ballkanit Perëndimor ka mbështetur mbi 150 projekte në rajon nga të cilët kanë përfituar rreth 7000 të interesuar: <https://westernbalkansfund.org/>

3

PROCESI I BERLINIT DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

BE-ja e ka promovuar bashkëpunimin rajonal ndër vite si një element të rëndësishëm të politikës së saj të zgjerimit. Që prej fillimit të Procesit të Stabilizim-Asociimit në vitin 1999, bashkëpunimi rajonal u bë pjesë qendrore e politikës së kushtëzimit, krahas kritereve të Kopenhagës. Procesi i Berlinit e ridimensionoi këtë qasje, duke e vendosur bashkëpunimin rajonal në qendër të procesit të integritit evropian dhe duke përfshirë shumicën e fushave të politikave sektoriale, me një theks të veçantë në çështjet ekonomike.²¹ Përveç aspektit politik, u përfshinë masa konkrete për bashkëpunim në fushën e infrastrukturës, tregtisë, investimeve, lëvizshmërisë ose digjitalizimit. Bazuar në eksperiencën e Gjermanisë dhe të Francës pas Luftës së Dytë Botërore, fokusi u vu kryesisht në integrimin ekonomik, me shpresën se ky qëllim i përbashkët do të konsolidonte dhe do të rriste bashkëpunimin rajonal. Në këtë mënyrë, intensifikimi i bashkëpunimit rajonal dhe rritja e mirëqenies së vendeve u kthyen në objektivat kryesorë të këtij procesi.

Vështruar nëntë vite më pas, rezultatet në praktikë mbeten të kufizuara. Format i ri i bashkëpunimit rajonal pati disa efekte pozitive duke çuar në shumëfishimin e takimeve në të gjitha nivelet, çka ndihmon në ndërtimin e besimit dhe të marrëdhënieve ndërpersonale. Edhe pse në aspektin politik Procesi i Berlinit ofroi një platformë për udhëheqësit e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor, ku u diskutuan çështje bilaterale dhe u promovuan nisma të reja, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit rajonal ekonomik, konfliktet e pazgjidhura dhe mosmarrëveshjet dypalëshe vazhdojnë të mbeten problematike, duke u bërë shpesh burim i paqëndrueshmërisë e duke penguar në këtë mënyrë përbushjen e objektivave të kësaj nisme, por dhe rrugëtimin e vendeve të rajonit drejt BE-së.

Procesi i Berlinit nuk ka arritur të tejkalojë mosmarrëveshjet dypalëshe, të cilat pengojnë bashkëpunimin e njëmend rajonal. Ndonëse ka kaluar çerek shekulli nga Marrëveshja e Dayton-it dhe 20 vite nga përfundimi i luftës në Kosovë, konflikti i papërfunduar midis Serbisë dhe Kosovës, si dhe

funksionaliteti i Bosnje-Hercegovinës mbeten algoritmet e pazgjidhura të sigurisë në rajon.

Në lidhje me bashkëpunimin ekonomik, në kuadër të Procesit të Berlinit u miratua Plani Shumëvjeçar i Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (2017-2019) dhe Tregu i Përbashkët Rajonal (2020–2024). Po kështu, u miratua Protokollin shtesë 5 i CEFTA-s për njohjen e kontrolleve fito-sanitare e bujqësore, njohjen e ndërsjellë të Operatorëve të Autorizuar Ekonomikë, sikundër është në proces ratifikimi Protokollin 6 i CEFTA-s, që synon lehtësimin e procedurave të kalimit të kufirit për mallrat dhe shërbimet. Gjithsesi, rezultatet e integritit ekonomik rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor mbeten modeste, por ende të konsiderueshme. Për shkak të CEFTA-s eksportet në përgjithësi të mallrave përfundimtare, dhe më pak të mallrave të ndërmjetme janë rritur.²² Efektet e ndryshme të rritjes së eksportit sugjerojnë se shtetet pjesëmarrëse në CEFTA janë pozicionuar ndryshe në CEFTA dhe në zinxhirët e vlerës globale. Shifrat tregojnë një integrim më të madh të Serbisë në zinxhirët e vlerës globale.²³

Duhet pranuar se ekonomia e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht lidhjeve të ngushta me BE-në, është e fragmentuar. Niveli i tregtisë brendarajonale është ende i ulët, veçanërisht për shkak të mungesës së mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme. Gjithsesi, tregtia brendarajonale vjen e dyta, pas nivelit të shkëmbimit tregtar me BE-në, duke përfaqësuar një të pestën e të gjithë eksporteve dhe një të dhjetën e importeve.²⁴ Eksportuesi kryesor në tregtinë brendarajonale është Serbia. Ndërsa, importuesit kryesorë janë Kosova dhe Bosnje-Hercegovina.²⁵

Gjatë viteve të funksionimit të CEFTA-së, eksportet serbe janë devijuar nga CEFTA drejt BE-së: në vitin 2006, Serbia eksportoi 25.6% të mallrave të saj në CEFTA, por deri në vitin 2020 kjo shifër ishte vetëm 14.1%. Ndërkohë, shifrat përkatëse për eksportet serbe në BE ishin përkatësisht 62% dhe 68%. Kjo tregon një integrim më të madh të Serbisë

²¹Për më tepër informacion shih: Florent Marciacq "The EU and the Western Balkans after the Berlin Process Reflecting on the EU Enlargement in Times of Uncertainty", 2017: <http://oefz.at/2017/12/07/the-eu-and-the-western-balkans-after-the-berlin-process-reflecting-on-the-eu-enlargement-in-times-of-uncertainty-policy-study-marciacq-florent-20-17/> dhe Matteo Bonomi "Off Track. The EU's Re-engagement With the Western Balkans", 2019: <https://www.iai.it/en/pubblicazioni/track-eus-re-engagement-western-balkans>

²²Për një analizë më të hollësishme shih: Nina Vujanović, "CEFTA: Trade and Growth Patterns Fifteen Years since Establishment", 2023: <https://cefta.int/wp-content/uploads/2019/01/cefta-trade-and-growth-patterns-fifteen-years-since-establishment-dlp-6508.pdf>

²³Po aty.

²⁴Plamen Kaloyanchev, Ivan Kusen, & Alexandros Mouzakis, "Untapped Potential: Intra-Regional Trade in the Western Balkans" European Economy Discussion Papers, 2018: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/dp080_western_balkans.pdf

²⁵Përdëhënatë më tejshmeshih: Eurostat Western Balkans-EU international trade in goods statistics.

në Zinxhirët e Vlerës Globale (Global Value Chains). Për më tepër, vlen të theksohet se CEFTA ka rritur eksportet e mallrave përfundimtare, por më pak të mallrave të ndërmjetme.²⁶

Nga ana tjetër, Procesi i Berlinit i ka kushtuar vëmendje investimeve infrastrukturore. Në veçanti, përmes agjendës së ndërlidhjes të mbështetur nga BE-ja, procesi pati sukses në vendosjen e Ballkanit Perëndimor në hartën e transportit dhe të energjisë të Europës.²⁷ Mbështetja e agjendës së ndërlidhjes si nxitës i rritjes ekonomike, synon transformimin e Ballkanit Perëndimor në një rajon më të unifikuar. Për pasojë, më tërheqës për investime dhe tregti.

Gjithashtu, Procesi i Berlinit krijoi sinergji pozitive ndërmjet të rinjve, shoqërisë civile, Dhomave të Tregtisë mbështetur në përvojat e vendeve të ndryshme të BE-së.

²⁶Oliver Reiter & Robert Stehrer, "Value chain integration of the Western Balkan countries and policy options for the post-Covid-19 period", 2021, wiiw Policy Note/Policy Report 48, Vienna

²⁷Për më shumë informacion shih: <http://oefz.at/2017/12/07/the-eu-and-the-western-balkans-after-the-berlin-process-reflecting-on-the-eu-enlargement-in-times-of-uncertainty-policy-study-marciacq-florent-2017/>

4

BALLKANI I HAPUR LEHTËSUES APO ALTERNATIVË NDAJ PROCESIT TË BERLINIT?

Idea për krijimin e Ballkanit të Hapur fillimisht u prezantua në formatin e një mini-Schengen-i në tetorin e vitit 2019, gjatë takimit në Novi Sad të presidentit të Serbisë dhe kryeministrave të Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi kryesor i nismës ishte thellimi i bashkëpunimit rajonal nëpërmjet promovimit të lëvizjes së lirë të mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit (katër “liritë” e BE-së). Nisma mori jetë në një kohë kur Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut iu bllokua nisja e bisedimeve për anëtarësim në BE nga Franca, e cila këmbëngulte në rishikimin e metodologjisë së zgjerimit dhe të reformimit të BE-së.

Vlen të theksohet pronësia mbi këtë nismë rajonale që vjen nga tri shtete të rajonit, edhe pse në të shkuarën s’kanë munguar nisma të tilla. Disa në formate trepalëshe apo katërpalëshe, e të tjera si Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEEC), në një format të gjerë e gjithëpërfshirës.

Megjithëse në këtë nismë u ftuan të gjitha vendet e rajonit, në dallim nga platformat e tjera të bashkëpunimit rajonal, ndaj saj pati reagime hezituese nga Kosova, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi.²⁸ Shqetësimi kryesor qëndron tek dobia e nismës dhe vështirësia e saj për të siguruar gjithëpërfshirjen, duke garantuar barazinë e aktorëve pjesëmarrës si një nga parimet kryesore të bashkëpunimit të frytshëm rajonal.

Më skeptikja në lidhje me këtë nismë është shfaqur Kosova. Të gjithë udhëheqësit politikë, pavarësisht krahut që përfaqësojnë, e kanë kundërshtuar pjesëmarrjen në këtë nismë. Këto kundërshti lidhen kryesisht me mosnjohjen e shtetësisë së Kosovës nga Serbia, rrezikun që kjo nismë të dublojë Procesin e Berlinit dhe procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE, sikundër me përfitimet ekonomike të Serbisë përkundrejt Kosovës.²⁹ Megjithëse në dokumentin për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë të ndërmjetësuar nga SHBA-ja, apo siç njihet ndryshe “Marrëveshja e Uashingtonit”, Kosova u zotua që të bëhej pjesë e kësaj nisme, një gjë e tillë nuk u bë realitet.³⁰

²⁸Për më shumë argumente pro shih: <https://www.ifimes.org/en/researches/2022-open-balkan-the-future-belongs-to-the-peoples-of-the-balkans/5060/> Dhe për argumente kundër shih: <https://balkaninsight.com/2022/06/16/open-balkans-shows-no-sign-of-delivering-promised-freedoms/>

²⁹Për më shumë informacion shih: <https://www.riinvestinstitute.org/Al/riinvest-blog/308/mini-quot-mini-schengen-quot-bleron-menzelxhiu/>

³⁰Shih dokumentin e nënshkruar më 4 shtator 2020 nga Kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti.

Pandemia, si dhe proceset zgjedhore të zhvilluara në Maqedoninë e Veriut e Serbi, e penguan zhvillimin normal të nismës gjatë vitit 2020. Në korrik të vitit 2021, në takimin e mbajtur në Shkup në kuadër të Forumit Ekonomik Rajonal, mini-Schengen u vendos të quhej Ballkan i Hapur. Në një deklaratë të përbashkët të Presidentit të Serbisë, Kryeministrit të Shqipërisë dhe atij të Maqedonisë së Veriut, theksohet përkushtimi i vendeve pjesëmarrëse për zbatimin e “katër lirive”. Në funksion të këtij angazhimi u nënshkruan tre Memorandume Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi.³¹

Pavarësisht pjesëmarrjes në disa takime të zyrtarëve nga Bosnje-Hercegovina apo Mali i Zi, qëndrimi i këtyre dy shteteve në thelb nuk ndryshoi, duke nënvizuar mungesën e përfitimeve politike dhe ekonomike nga pjesëmarrja në këtë nismë.³² Sipas pozicionit të Ministrisë për Europën të Malit të Zi, Ballkanit të Hapur i mungon një udhërrëfyes, strategji apo kornizë institucionale, që do të garantonte një marrëdhënie dhe pozicion të barabartë të vendeve pjesëmarrëse në të.³³ Në të njëjtën linjë Mali i Zi ka kundërshtuar pjesëmarrjen në këtë nismë, duke argumentuar se qëllimin kryesor është anëtarësimi në BE, dhe jo një alternativë ndaj tij.

Çështjet kryesore që ngrihen në raport me këtë nismë kanë të bëjnë me përfitimet që ajo sjell dhe risitë krahasuar me nismat ekzistuese të bashkëpunimit rajonal. Sipas nismëtarëve, Ballkani i Hapur nuk synon të zëvendësojë Procesin e Berlinit dhe as procesin e integritimit në BE. Përkundrazi, synon ta plotësojë atë duke krijuar bashkëpunim dhe sinergji për të përgatitur më mirë shtetet pjesëmarrëse drejt anëtarësimit në BE.³⁴ Gjithsesi, është e vështirë të argumentohet nevoja për ekzistencën e një nisme paralele që synon arritjen e objektivave të njëjta me ato të Procesit të Berlinit, pa pasur mekanizmat ose instrumentet e këtij procesi.

Ndryshe nga marrëveshjet e arritura në kuadër të Procesit të

³¹1. Marrëveshja për mobilizimin e të tre vendeve për sa i përket përballimit të katastrofave natyrore; 2. Marrëveshje mirëkuptimi për të lehtësuar importin dhe eksportin e mallrave; 3. Marrëveshje për qarkullim e lirë në tregun e punës.

³²Për më shumë shih: <https://balkaninsight.com/2021/07/29/balkan-mini-schengen-leaders-eye-open-borders-by-2023/>

³³Analizë e Ministrisë Malazeze për Çështjet Evropiane; për më shumë informacion: <https://www.euractiv.com/section/politics/news/montenegro-questions-transparency-strategy-of-open-balkan-initiative/>

³⁴Për më shumë informacion: <https://ata.gov.al/2022/10/12/rama-procesi-i-berlini-dhe-ballkani-i-hapur-nuk-perjashtojne-njeri-tjetrin/>

Berlini si Plani i Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale dhe Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, Ballkani i Hapur nuk ka një dokument që përcakton objektivat dhe fushëveprimin e tij. Ai bazohet në Deklaratat e Përbashkëta të miratuara gjatë takimeve a samiteve në kuadër të kësaj nisme. Pas Deklaratës së Novi Sadit në tetor të vitit 2019, që propozoi krijimin e kësaj nisme,³⁵ u nënshkruan dy deklarata të tjera në Ohër, në nëntor të vitit 2019 dhe në Tiranë në dhjetor të vitit 2019. Deklarata e parë synonte përshtetësinë e zbatimit të Zonës Ekonomike Rajonale duke identifikuar një listë masash prioritare në lidhje me katër liritë.³⁶ Ndërsa konkluzionet e takimit të Tiranës nënvizojnë rëndësinë e kësaj nisme në funksion të përgatitjes së rajonit për anëtarësimin në BE.³⁷

Deklaratat e përbashkëta, konkluzionet e samiteve, memorandumet dhe marrëveshjet nuk përshkruajnë hapat se si ky vizion do të zbatohet në të ardhmen e afërt. Nga ana tjetër, heqja e kontrolleve kufitare për të përmbushur një premtim të ndërmarrë nga iniciuesit e kësaj nisme, pa instaluar sisteme të forta të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë, mund të nxitë tregtinë e paligjshme, duke shtuar problemet ekzistuese të krimit të organizuar dhe duke dëmtuar imazhin e këtyre vendeve.³⁸

Nëse krahasojmë objektivat e Ballkanit të Hapur me Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal,³⁹ vihet re një mbivendosje. Disa nga marrëveshjet e nënshkruara nga vendet pjesëmarrëse në Ballkanin e Hapur janë përfshirë më parë në Planin e Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale ose janë integruar në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal.⁴⁰ Zbatimi i këtyre veprimeve do të ishte më i frytshëm nëse do të bëhej nga të gjitha vendet nën ombrellën e Tregut të Përbashkët Rajonal. Edhe nëse Ballkani i Hapur u iniciua për të tejkaluar ritmin e ngadaltë të zbatimit të nismave ekzistuese të integritetit rajonal, ecja përpara nuk duhet të rrezikojë cilësinë e zbatimit dhe as nuk duhet të devijojë nga standardet e BE-së.

Për më tepër, duke mos u përfshirë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk do të shfrytëzohet siç duhet potenciali i tregtisë brendarajonale. Të dhënat mbi tregtinë e mallrave sugjerojnë se eksportet e Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Serbisë janë më të larta me vendet jo pjesëmarrëse. Për shembull, Kosova thith pjesën më të madhe të vlerës së eksportit si nga Maqedonia e Veriut (40.78%) dhe Shqipëria (58.07%), ndërsa Bosnje-Hercegovina është tregu kryesor eksportues i Serbisë në

rajon.⁴¹ Thënë këtë, përfituesi kryesor nga heqja e barrierave do të jetë ekonomia me e fortë, që në kuadër të Ballkanit të Hapur është Serbia, e cila gjeneron gjysmën e prodhimit vendor bruto të rajonit.

Sipas nismëtarëve të Ballkanit të Hapur, gjatë vitit 2022 shkëmbimi tregtar mes vendeve pjesëmarrëse është rritur, duke evidentuar se kjo rritje është rezultat i Ballkanit të Hapur.⁴² Megjithëse eksportet dhe importet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut e Serbisë kanë njohur rritje, vihet re se kjo rritje është vetëm për vlerën e produkteve të shkëmbyera dhe jo në sasi. Madje, në sasinë e importuar dhe eksportuar ka rënie përgjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021.⁴³

Më konkretisht, siç shihet në grafikët e mëposhtëm, gjatë vitit 2022 eksportet dhe importet me Maqedoninë e Veriut megjithëse u rritën në vlerë, përkatësisht me 35% dhe 11.7%, në sasinë e mallrave të shkëmbyera pati një rënie prej 3.3% dhe 17%. E njëjta prirje vihet re edhe me Serbinë. Eksporti pati një rritje në vlerë prej 26% dhe rënie në sasi po me 26%, ndërsa importi u rrit në vlerë me 13%, por u ul në sasi me 18.6%.⁴⁴

Kjo mund të argumentohet me rritjen e çmimeve që ka ndodhur sidomos gjatë vitit 2022, si pasojë e luftës në Ukrainë. Në fakt kjo prirje, ku raporti mes vlerës dhe sasisë në tregti nuk është një raport në përpjesëtim të drejtë, vihet re edhe nëse do të përfshihen në analizë dhe të dhënat tregtare nga Kosova, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina.

³⁵<https://balkaninsight.com/2019/10/10/albania-north-macedonia-serbia-sign-mini-schen-gen-declaration/>

³⁶Për më shumë shih: <https://cep.org.rs/en/blog/open-balkan-initiative/>

³⁷Shih Deklaratën e Tiranës: <https://api.pks.rs/storage/assets/final-tirana-declaration.pdf>

³⁸Për më shumë informacion shih: <https://cep.org.rs/en/blog/open-balkan-initiative/> dhe Stefan Ristovski, Simonida Kacarska, "Open Balkan, Berlin Process and EU's Acquis Rapid analysis within the assessing and streamlining potentials of the Open Balkan Initiative", 2022.

³⁹Plan i Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal: <https://www.rcc.int/docs/543/common-regional-market-action-plan>

⁴⁰Si për shembull, marrëveshjet për masa fito-saniare ose njohjen reciproke të autorizimeve të operatorit ekonomik të autorizuar (AEOS).


⁴¹Për më shumë informacion shih publikimin e European Policy Institute Skopje: <https://epi.org.mk/post/21533?lang=en>

⁴²Deklaratë gjatë konferencës për media pas takimit mbajtur në Verona të Italisë në panairin "VinItaly", presidenti i Serbisë dhe kryeministrat e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.


⁴³Bazuar në të dhënat e INSTAT: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__FT__FTY/NewFTY004/

⁴⁴Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__FT__FTY/NewFTY004/

Grafiku 1: **Import/Eksport pesha në kg**



Grafiku 2: **Import/Eksport vlera në lekë**



Me synim sigurimin e një mbështetjeje më të gjerë në planin ndërkombëtar, nismëtarët e Ballkanit të Hapur ftuan edhe vende si Italia, Greqia, Turqia dhe Hungaria për t'u bërë pjesë e tij. Në takimin e fundit të mbajtur në Beograd në shtator të vitit 2022, thirrjes së nismëtarëve iu përgjigjën vetëm Turqia dhe Hungaria.

BE-ja kërkon përqendrimin e përpjekjeve për rritjen e bashkëpunimit rajonal në nisma që i përfshijnë të gjashtë vendet e rajonit, nisma të cilat i mbështet financiarisht. Ndërkohë SHBA-ja mbështeti nismën e Ballkanit të Hapur për sa kohë që bashkëpunimi mbetet vetëm në rrafshin ekonomik dhe jo në atë politik, si dhe bazohet në rregullat e BE-së me qëllim përparimin drejt BE-së.⁴⁵

Që prej takimit të fundit në Beograd dhe pjesëmarrjes në disa panairë për promovimin e verërave nga rajoni, si dhe me ripërtëritjen e Procesit të Berlinit nga Kancelari gjerman Scholz, duket sikur vlera e Ballkanit të Hapur është relativizuar. Por Ballkani i Hapur ka potencialin e krijimit të një agjende ekonomike pozitive, bazuar në frytet e Procesit të Berlinit, për kthimin e vendeve të rajonit në destinacion tërheqës turistik dhe kulturor, sikundër në promovimin e vlerave dhe produkteve të tyre.

Organizimi i Samitit BE-Ballkan Perëndimor në dhjetor të vitit 2022 në Tiranë, si dhe vendimi për organizimin e Samitit të ardhshëm të Procesit të Berlinit në Shqipëri në vjeshtën e vitit 2023, përçon një mesazh të qartë të BE-së për një vëmendje të shtuar dhe mbështetje të Procesit të Berlinit. Ndaj është e rëndësishme që progresi në këtë proces të mos trajtohet më në mënyrë teknike, por përmes angazhimit të përbashkët politik të vendeve të rajonit dhe BE-së.

⁴⁵Deklarata e të dërguarit të posaçëm të SHBA-së për Ballkanin Perëndimor Gabriel Escobar. Për më shumë shih: <https://www.zeramerikes.com/a/6607996.html>

5

SFIDAT QË KËRKOJNË PËRGGJIGJE

Edhe pse kanë kaluar 20 vite nga Samiti i Selanikut, ku u konfirmua perspektiva e anëtarësimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor, anëtarësimi i vendeve të rajonit mbetet një premtim i papërbushur. Nismat, formatet dhe risitë institucionale në mbështetje të këtij procesi kanë qenë të shumta, duke filluar nga Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore e deri te përditësimi i vazhdueshëm i metodologjisë së procesit të zgjerimit nga Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit të Procesit të Berlinit ose samitet vjetore ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. E megjithatë, rruga e vendeve të rajonit drejt BE-së vijon të jetë e thepisur dhe pa një afat kohor të qartë. Pesë janë sfidat e ndërlidhura që duhen trajtuar në funksion të stabilitetit demokratik, mirëqenies dhe anëtarësimit në BE:

Së pari, niveli i demokracisë dhe i sundimit të së drejtës. Edhe pse zbatim i reformave në kuadër të integritetit në BE duhet të përmirësojë nivelin e demokracisë dhe të ndihmojë në forcimin e shtetit të së drejtës, situata në Ballkanin Perëndimor nuk e vërteton plotësisht këtë. Në të kundërt, bazuar në vlerësimet e organizatave ndërkombëtare që monitorojnë zhvillimet demokratike, vihet re një “rëshqitje demokratike” në vitet e fundit, me përjashtim të Kosovës. Suksesi i reformave në fushën e sundimit të së drejtës është i lidhur me suksesin ekonomik dhe të ardhurat e individit. Duke pritur jashtë dyerve të BE-së, rritja ekonomike e vendeve të Ballkanit Perëndimor është ngadalësuar. Në këtë mënyrë, besimi se sistemet demokratike do të sjellin vetvetiu një transformim, është tularur. Kështu, përparimi drejt BE-së nuk është në raport të drejtë me fuqizimin e shtetit të së drejtës. Megjithatë, në këtë pikë BE-ja përballet me sfida të brendshme. Edhe pse vlerat janë gurë themeli për funksionimin e BE-së, shpesh është vënë në pikëpyetje mekanizmi dhe mënyra se si sigurohen këto vlera brenda BE-së.

Së dyti, hendeku zhvillimor i rajonit me mesataren e BE-së. Ballkani Perëndimor është i pazhvilluar krahasuar me mesataren e vendeve të BE-së, por edhe krahasuar me vendet më të varfra të bllokut. PBB i të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor është afërsisht i barabartë me atë të Sllovakisë, ose më pak se 1% i atij të BE-së.⁴⁷ Pavarësisht

përfitimeve ekonomike që kanë sjellë nisma të ndryshme rajonale ose potenciali që mbart Tregu i Përbashkët Rajonal, zhvillimi ekonomik i rajonit mbetet i kufizuar, pasi Ballkani Perëndimor varet nga tregtia dhe investimet e huaja direkte me origjinë nga BE-ja, në një masë më të madhe sesa nga tregtia brendarajonale.

Kjo situatë do të ishte ndryshe nëse BE-ja do ta trajtonte Ballkanin Perëndimor me të njëjtin solidaritet siç trajton të prapambeturit ekonomikë brenda saj, shumica prej tyre fqinje të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mënyra më e mirë për të përmirësuar bashkëpunimin në rajonin tonë është zbatimi i politikave që synojnë rritjen e të ardhurave individuale. Për shembull, transfertat nga buxheti i BE-së tek anëtarët në Europën Qendrore e Lindore konsiderohen faktori kryesor shtytës i rritjes së të ardhurave individuale.⁴⁸

Gjithsesi, për të përfituar nga politika e kohezionit dhe e solidaritetit të BE-së, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të garantojnë zbatimin e normave europiane në fushën e prokurimit publik dhe konkurrencës, sikundër të përmirësojnë parametrat dhe indikatorët matës të luftës kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar.

Së treti, kërcënimi demografik. Ndërkohë që thelbi i procesit të integritetit evropian është ndërtimi i një jete më të mirë për vendet që synojnë anëtarësimin në BE, vendet e rajonit po përballet me ikje masive të qytetarëve drejt BE-së, për një jetë më të mirë e me dinjitoze. Për të inkurajuar qytetarët që të mos e braktisin rajonin, nuk mjaftojnë marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe kualifikimeve profesionale të përmbyllura në kuadër të Procesit të Berlinit, megjithë vlerën e pamohueshme të tyre në një plan afatgjatë anëtarësimi të mundshëm në BE. Për profesionistët nga rajoni është më e leverdisshme të zgjedhin veriun e Europës sesa një nga vendet e Ballkanit Perëndimor. që ofron pak a shumë të njëjtin standard jetesë. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përqafojnë politikën e mirëqenies që lidhen me investimet dhe mundësitë në arsim, shëndetësi dhe strehim, duke krijuar një terren më të përshtatshëm për një jetë më dinjitoze. Nga ana tjetër, trajtimi i

⁴⁶Për më shumë shih poshtë shënimin 8 në faqen 4.

⁴⁷Shih Bertelsmann Foundation and WIIW, “Pushing on a String? An evaluation of regional economic cooperation in the Western Balkans”, 2020: <https://www.bertelsmann-stiftung.de/de/publikationen/publikation/did/pushing-on-a-string-en>

⁴⁸Bertelsmann Foundation and WIIW, “The long way round: Lessons from EU-CEE for improving integration and development in the Western Balkans”, 2022: <https://wiiw.ac.at/the-long-way-round-lessons-from-eu-cee-for-improving-integration-and-development-in-the-western-balkans-p-6194.html>

Ballkanit Perëndimor si pjesë e BE-së është një mënyrë efektive për të zbutur hendekun zhvillimor dhe për të frenuar sadopak fenomenin e shpopullimit.

Së katërti, kufizimet e bashkëpunimit rajonal. Megjithëse bashkëpunimi rajonal është pjesë e rëndësishme e procesit të integritetit evropian, potenciali i tij është i kufizuar. Mosmarrëveshjet dypalëshe, jo vetëm midis vendeve të rajonit, por edhe midis tyre dhe vendeve të BE-së, kanë ndikuar në ngadalësimin e bashkëpunimit, rikthimin ciklik të tensioneve, si dhe në ngecjen e procesit të integritetit evropian, duke qenë se as BE-ja dhe as Procesi i Berlinit nuk kanë një mekanizëm konkret për tejkalimin e tyre. Për më tepër, siç ka treguar përvoja e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, bashkëpunimi rajonal u rrit më shumë pasi këto vende u bënë anëtare të BE-së.⁴⁹

Së pesti, mungesa e vizionit të BE-së kundrejt Ballkanit Perëndimor. Që prej zgjerimit të madh me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, procesi i zgjerimit të BE-së ka pushuar së qeni magnet transformimi dhe zhvillimi për vendet e rajonit tonë, nuk ka arritur të zbutë mosmarrëveshjet dypalëshe ose çështjet e përfundimit të shtetësisë, të cilat pengojnë çlirimin e energjive për bashkëpunim më të thelluar rajonal, mirëqenie dhe rritje ekonomike. E megjithatë, Procesi i Berlinit mbetet e vetmja platformë e bashkëpunimit rajonal me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve të rajonit dhe vendeve kyçe të BE-së. Për të prodhuar suksesin e dëshiruar, ky proces duhet ndërlidhur me agjendën zhvillimore dhe me një vizion konkret për anëtarësimin e vendeve të rajonit në BE, në një afat kohor të përcaktuar.

⁴⁹Më konkretisht, tregtia në mallra dhe shërbime ndërmjet tyre u rrit me afërsisht 50%, pas pranimit të tyre në BE; për më shumë informacion shih Bertelsmann Foundation and WIIW, "The long way round: Lessons from EU-CEE for improving integration and development in the Western Balkans": <https://wiiw.ac.at/the-long-way-round-lessons-from-eu-cee-for-improving-integration-and-development-in-the-western-balkans-p-6194.html>

6

ZEITENWENDE DHE IMPLIKIMET E TIJ PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Në vitin 2005, pak para së të zgjidhej Kancelare e Gjermanisë, Angela Merkel do të deklaronte në një intervistë për Frankfurter Allgemeine Zeitung se “me politikën e tanishme të zgjerimit, BE ka prekur limitin e aftësisë së saj për të integruar anëtarë të rinj”, duke kërkuar një fazë konsolidimi për BE-në para se kjo e fundit të mendonte për anëtarë të rinj.

Gjermania nën drejtimin e Angela Merkel është identifikuar më shumë me status quo në Ballkanin Perëndimor sesa me një vizion të qartë për anëtarësimin e këtyre vendeve në BE. Roli i Gjermanisë ka qenë përcaktues në zbrapsjen e ideve të rrezikshme për ndryshimin e kufijve. Pësia dhe prania e Gjermanisë në rajon është e pakrahasueshme me atë të vendeve të tjera europiane. Megjithatë, impakti i rezultateve në terren i nismave të saj mbetet i kufizuar.

Pozicioni i qartë gjerman në raport me epilogun e dialogut Serbi–Kosovë nuk ka arritur të prodhojë impakt të ndjeshëm te qytetarët e dy vendeve. Plani franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili u kthye në një plan evropian, pas mbështetjes që mori nga vendet anëtare të BE-së më 9 shkurt 2023, ende nuk po e nxjerr raportin Kosovë–Serbi nga gjendja e konfliktit të papërfunduar.

Nisma e përbashkët gjermano-britanike e vitit 2015 për Bosnje–Hercegovinën nuk e zhblokoi dot perspektivën europiane e as arkivoi idetë e rrezikshme për zhbërjen e saj. Për shkak të zhvillimeve regjive, disa vite më vonë Gjermania është e shtrënguar të flasë për sanksione ndaj Dodikut, udhëheqësit separatist të serbëve të Bosnjës.

Ripërtëritja e Procesit të Berlinit nga Kancelari Scholz shihet me optimizëm të përmbajtur kur kujton nismën “Berlin plus” të artikuluar nga ish Ministri i Jashtëm gjerman Sigmar Gabriel që synonte përfshirjen e më shumë elementeve të zhvillimit ekonomik të rajonit. Një nismë që nuk arriti të sigurojë mbështetjen e duhur financiare.

Megjithatë, fjalimi i 27 shkurtit 2022 i Kancelarit Scholz në seancën posaçme të Bundestagut gjerman, pas agresionit rus kundër Ukrainës, i konsideruar edhe si Zeitenwende (pikë

kthese) për shkak të angazhimeve të ndërmarra dhe vizionit të shpalosur, ka zgjuar shpresat për konsolidimin e projektit evropian. Kancelari njoftoi se Gjermania do të përmbushë dhe do të kapërcejë objektivin e shpenzimeve të NATO-s prej 2% në raport me PBB, dhe krijimin e një fondi të posaçëm prej 100 miliardë euro për të siguruar shpenzimet e rëndësishme të mbrojtjes në vitet e ardhshme. Ai theksoi gjithashtu se Gjermania do të mbrojë çdo cep të territorit të Aleancës.⁵¹

Për shkak të përgjegjësisë historike dhe të kaluarës së hidhur, qeveritë gjermane tradicionalisht janë kujdesur të shmangin rritjen e shpenzimeve ushtarake. Tani, me të njëjtin argument, rritja e shpenzimeve ushtarake është e përligjur. Ky ndryshim ndodhi edhe falë mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, të cilët presin një rol në rritje të Gjermanisë. Me sa duket, për këtë u desh një luftë në Europë.

Gjermania ka nënvizuar vazhdimisht se lufta në Ukrainë duhet të shërbejë si një paralajmërim për Ballkanin Perëndimor. Objektivat e programit të qeverisë gjermane, që lidheshin me fillimin e bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut në BE, procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, akordimin e statusit të vendit kandidat për në BE për Bosnje–Hercegovinën, u përmbushën edhe si pasojë e situatës së sigurisë në Europë të krijuar nga agresioni rus në Ukrainë.

Strategjia e re e Sigurisë Kombëtare të Gjermanisë thekson domosdoshmërinë e përsheptimit të procesit të anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, pas reformimit të mënyrës së funksionimit të institucioneve të BE-së⁵². BE-ja është një bashkim shtetesh ku, për momentin, nuk mund të injorohet vështirësia e vendimmarrjeve të përbashkëta. Më shumë anëtarë, më e vështirë të marrësh vendime. BE-ja funksionon mbi parimin e solidaritetit. Disa anëtarë paguajnë më shumë sesa të tjerët, dhe sa më shumë anëtarë të ketë, veçanërisht nëse janë të varfër, aq më pak para do të ketë për anëtarët e varfër që janë brenda BE-së. Pra, mënyra e vendimmarrjes, buxheti dhe përfaqësimi do të jenë elementë thelbësorë për procesin e zgjerimit.

Historikisht BE-ja ka qenë e kujdesshme në raport me

⁵⁰Për më shumë shih konkluzionet e Këshillit Evropian: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-1-2023-INIT/en/pdf>

⁵¹Këto angazhime u trupëzuan në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Gjermanisë. Për më shumë shih: <https://www.nationalesicherheitsstrategie.de/en.html>

⁵²Shih: <https://www.nationalesicherheitsstrategie.de/en.html>

zgjerimin. Zgjerimi më i madh i BE-së erdhi pas fundit të Luftës së Ftohtë, me përfundimin e luftës në Kosovë. Ajo që shohim sot me agresionin rus në Ukrainë është një mundësi për udhëheqësit europianë që të mendojnë se si mund ta bëjmë të pamundur luftën në Europë, si mund të krijojmë një Europë më të fortë. Ky është një çast kur mund të argumentohet se është më e vështirë një BE me më shumë anëtarë, si në mënyrën e të vepruarit edhe në kuptimin financiar, por përparësitë janë më të mëdha. Pasi një gjë e tillë do ta bënte luftën të pamendueshme. Do të krijonte një hapësirë të madhe me një treg të vetëm, pa pengesa ndërmjet shteteve dhe qytetarëve, dhe një Europë më të fortë që trajton pasojat e përfundimit të luftërave në ish Jugosllavi dhe agresionin në lindje të kontinentit. Me luftën në Ukrainë dhe ndërgjegjësimin se Europa nuk është e plotësuar, kjo duhet të shihet edhe si një mundësi për të jetësuar vizionin e anëtarësimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Momenti në të cilin gjendet Europa tani është një dritare mundësie për të sjellë një shtytje të re drejt zgjerimit të BE-së, për arsye gjeostrategjike, si dhe një sinjal fuqie që tregon se BE-ja është e aftë dhe e gatshme të ripërtërihet, të rritet dhe të promovojë vlerat e saj kundrejt fuqive konkurruese. Ndonëse BE-ja nuk është një fuqi ushtarake, ajo mund të thellojë ndikimin e saj si një fuqi ekonomike dhe normative. Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor duhet të marrë përparësi, ku BE-ja duhet të demonstrojë përkushtim të njëmendtë.

Për disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor është gjithashtu çasti i së vërtetës në lidhje me Rusinë. Hapësira për neutralitet, paqartësi ose moslinjëzim të qëndrimeve e vendimeve në politikën e jashtme dhe në çështjet e sigurisë është tkurrur, duke u kthyer në një zgjedhje strategjike. Nga ana tjetër, shkëputja nga ndikimi rus do të duhet të shkojë paralelisht me mbështetjen thelbësore të BE-së për procesin e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Alternativat ndaj anëtarësimit të plotë dhe zgjatja e pafundme e këtij procesi janë rreziqe që duhen shmangur. Hapat gjysmakë përpara, si një fazë paraprake drejt anëtarësimit të plotë, nuk duhet të kthehen në një gjendje të përhershme për Ballkanin Perëndimor.

Gjermania duhet të jetë në ballë të kësaj sfide, jo vetëm në parandalimin e krizave ose në kontributin financiar, por edhe duke krijuar ndikim dhe ndryshim real politik në Ballkanin Perëndimor, njëherë e përgjithmonë. Kjo kërkon unitet midis shteteve anëtare dhe një listë të qartë të prioritetëve. Kushdo që mendonte se vendet anëtare të BE-së mund t'i kushtojnë më pak vëmendje konsolidimit demokratik dhe procesit të reformave përkundrejt stabilitetit dhe sigurisë, duhet të rishqyrtojë këtë tezë në sfondin e luftës në Europë.

Për të përmbushur plotësisht rolin e udhëheqësit në Europë, konsolidimin e projektit të integritit europian dhe fuqëzimit të lidhjes transatlantike, Berlinit do t'i duhet t'i japë fund *status quo*-së në Ballkanin Perëndimor, duke u përqendruar te sfidat reale me të cilat përballen vendet e rajonit, që kanë të bëjnë me përfundimin e shtetësisë, konsolidimin e

demokracisë dhe modelin e zhvillimit ekonomik e shoqëror, bazuar në rregulla mbi të cilat ka lulëzuar Europa. Përndryshe, asnjë angazhim për rritje të shpenzimeve në fushën e mbrojtjes nuk mund të parandalojë përshtatjet të ardhshme në kontinent.

BIBLIOGRAFIA

Bertelsmann Foundation and WIIW, “Pushing on a String? An evaluation of regional economic cooperation in the Western Balkans”, 2020: <https://www.bertelsmann-stiftung.de/de/publikationen/publikation/did/pushing-on-a-string-en>

Bertelsmann Foundation and WIIW, “The long way round: Lessons from EU-CEE for improving integration and development in the Western Balkans”, 2022: <https://wiiw.ac.at/the-long-way-round-lessons-from-eu-cee-for-improving-integration-and-development-in-the-western-balkans-p-6194.html>

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, “The Berlin Process in a Nutshell”, 2018: https://www.giz.de/en/downloads_els/The_Berlin_Process.pdf

Ditmir Bushati, “Ripërtëritja e Procesit të Berlinit”, Friedrich - Ebert - Stiftung Tirana, 2022: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/19730.pdf>

Dusan Ristic, “Open Balkan Initiative: Less History, More Business”, European Policy Centre, 2021: <https://cep.org.rs/en/blog/open-balkan-initiative/>

European Commission, Speech A new start for Europe 2014: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPE-ECH_14_567

European Council Conclusion, 2023: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-1-2023-INIT/en/pdf>

Florent Marciacq, “The EU and the Western Balkans after the Berlin Process Reflecting on the EU Enlargement in Times of Uncertainty”, 2017: <http://oefz.at/2017/12/07/the-eu-and-the-western-balkans-after-the-berlin-process-reflecting-on-the-eu-enlargement-in-times-of-uncertainty-policy-study-marciacq-florent-2017/>

Hellmut Hoffmann, Enrico Seewald, “Vazhdimësi dhe Shkëputje: Shqipëria dhe shtetet gjermane 1912-2021”, Shtëpia Botuese Onufri, 2022

Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë: http://data-baza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__FT__FTY/NewFTY004/

International Institute for Middle East and Balkan Studies, “The future belongs to the peoples of the Balkans”, 2022: <https://www.ifimes.org/en/researches/2022-open-balkan-the-future-belongs-to-the-peoples-of-the-balkans/5060?>

Maja Zivanovic, “Albania, North Macedonia, Serbia Sign ‘Mini-Schengen’ Declaration”, Balkan Insight, 2019 <https://balkaninsight.com/2019/10/10/albania-north-macedonia-serbia-sign-mini-schengen-declaration/>

Matteo Bonomi, “Off Track. The EU’s Re-engagement With the Western Balkans”, 2019: <https://www.iai.it/en/pubblicazioni/track-eus-re-engagement-western-balkans>

[track-eus-re-engagement-western-balkans](https://www.iai.it/en/pubblicazioni/track-eus-re-engagement-western-balkans)

Nina Vujanović, “CEFTA: Trade and Growth Patterns Fifteen Years since Establishment”, April 2023: <https://cefta.int/wp-content/uploads/2019/01/cefta-trade-and-growth-patterns-fifteen-years-since-establishment-dlp-6508.pdf>

Oliver Reiter & Robert Stehrer, “Value chain integration of the Western Balkan countries and policy options for the post-Covid-19 period”, 2021, wiiw Policy Note/Policy Report 48, Vienna

Plamen Kaloyanchev, Ivan Kusen, & Alexandros Mouzakis, “Untapped Potential: Intra-Regional Trade in the Western Balkans” European Economy Discussion Papers, 2018, https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/dp080_western_balkans.pdf

Relja Radovic, “Open Balkans Shows No Sign of Delivering Promised Freedoms”, 2022: <https://balkaninsight.com/2022/06/16/open-balkans-shows-no-sign-of-delivering-promised-freedoms/>

Sinisa Jakov Marusic, “Balkan ‘Mini-Schengen’ Leaders Eye Open Borders by 2023”, Balkan Insight, 2021: <https://balkaninsight.com/2021/07/29/balkan-mini-schengen-leaders-eye-open-borders-by-2023/>

Stefan Ristovski, “Comparison of the Open Balkan and Common Regional Market: What’s new for the regional economic integration in the Western Balkans?”, European Policy Institute, 2022: <https://epi.org.mk/post/21533?lang=en>

Stefan Ristovski & Simonida Kacarska, “Open Balkan, Berlin Process and EU’s Acquis Rapid analysis within the assessing and streamlining potentials of the Open Balkan Initiative”, European Policy Institute, 2022: <https://cea.org.mk/cea-rapid-analyses-of-the-open-balkan-initiative-the-berlin-process-the-economic-effects/?lang=en>

Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Gjermanisë, 2023: <https://www.nationalesicherheitsstrategie.de/en.html>

Velina Lilyanova, “The Western Balkans' Berlin process: A new impulse for regional cooperation”, European Parliamentary Research Service, 2016: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI\(2016\)586602_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI(2016)586602_EN.pdf)

Working Paper, Cooperation and Development Institute/ShtetiWeb, “Monitoring the Berlin Process: From Paris to Trieste”, 2017: <https://www.connectwith.eu.al/wpcontent/uploads/2019/07/Monitoring-the-Berlin-Process-From-Paris-to-Trieste.pdf>

MBI AUTORËT:

Ditmir Bushati ish Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, ish deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Albana Merja është e fokusuar në studimin e procesit të integritimit në BE, dinamikën e partive politike si dhe demokratizimin. Ajo ka përfunduar studimet për Shkencat Politike në Universitetin e Tiranës, dhe mban titullin M.A. në 'Politikën Evropiane Bashkëkohore' nga Universiteti i Sussex, në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo është autore e shumë studimeve dhe artikujve në fushën e saj të ekspertizës.

Glevin Dervishi është titulluar Doktor Shkencash për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, si dhe ka kryer studimet master për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Ai është autor i disa punimeve dhe artikujve shkencorë në këtë fushë. Aktualisht është Shef i Departamentit të Shkencave të Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Komunikimit në Akademinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

IMPRINT

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra e Tiranës
Rr. "Kajo Karafili" Nd-14, Hyrja 2, Kati 1,
Kutia Postare 1418, Tiranë, Shqipëri

www.tirana.fes.de

E-Mail: info.tirana@fes.de

Përgjegjës:

Stine Klapper | Drejtoreshë e Fondacionit "Friedrich Ebert", Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

Menaxhere Programi:

Mariola Qesaraku

Faqesja:

Enea Protopapa

Kërkimi shkencor dhe analiza e ndërmarrë për këtë botim janë të autoreve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionet e Fondacionit "Friedrich Ebert". Publikimet e Fondacionit "Friedrich Ebert" nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

© Tetor 2023

PROCESI I BERLINIT NË SFONDIN E RI
TË SIGURISË NË EUROPË

Për më shumë informacion:
www.tirana.fes.de/al/publikime/